



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “International Group Base” të datës 14.08.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 09.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës - LOTO 1 dhe LOTO 2” me nr. të prokurimit 616-24-1099-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “International Group Base” të datës 14.08.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 09.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës - LOT 1 dhe LOT 2” me nr. të prokurimit 616-24-1099-2-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “International Group Base” (tutje “parashtruesi”) me datë 14.08.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 09.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës - LOT 1 dhe LOT 2” me nr. të prokurimit 616-24-1099-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore “NE nuk pajtohem i vendimin tuaj pasi qe sipas LPP-e keni qene te obliguar te na kerkoni sqarime lidhur me mos marrjen e dokumentacionit konform Dosjes, pasi qe siq duket ka pasur telashe sistemi eprokurimit dhe nuk jane ngarkaur dokumentet e ofertes”.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se nuk është kontestues fakti që parashtruesi nuk ka ngarkuar së bashku me ofertën edhe dokumentet e kërkuara sipas DT. Kontestues sipas parashtruesit është fakti nëse përgjegjësinë për mosdorëzimin e ofertës nga parashtruesi duhet t’ a bartë vet parashtruesi apo AK.

Përmes nenit 32 par. 4 të RRPP është përcaktuar si në vijim “Është përgjegjësi e ofertuesit të ngarkoj të gjitha dokumentet e kërkuara në sistemin e prokurimit elektronik para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve. Çfarëdo dokumenti që duhet të jetë pjesë e ofertës/aplikacionit, ofertuesi duhet t’ a ngarkoj dhe dërgoj vetëm nëpërmjet funksionit “dorëzimi i tenderit” dhe jo nëpërmjet ndonjë funksioni tjetër. Koha e ngarkimit mund të dalloj në varësi të shpejtësisë (daljes) se lidhjes së internetit të ofertuesit dhe të ngarkesës së përgjithshme të sistemit. Pas afatit të fundit për dorëzimin e tenderit sistemi nuk lejon futjen e ndonjë dokumenti shtesë në lidhje me tenderin”. Mbi bazën e kësaj dispozite të RRPP, përcaktohet pa mëdyshje se përgjegjësia për dorëzimin e ofertës në mënyrë elektronike i takon ekskluzivisht parashtruesit respektivisht operatorit ekonomik tenderues. Pra AK nuk mund të mbaj përgjegjësi për gabimet që mund t’ i ndodhin operatorit ekonomik me rastin e dorëzimit të ofertës. Njëkohësisht nuk mund të kërkohen as sqarime shtesë pasi që ky veprim do t’ i mundësonte operatorit ekonomik dorëzimin e dokumenteve pas hapjes së ofertave dhe rrjedhimisht do të përbënte ndryshim material të ofertës që është rreptësisht e ndaluar përmes nenit 59 par. 2 të LPP ku thuhet “Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues”.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 15.08.2024

Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Faqe 2 nga 3

Adresa: Rr. “UÇK” nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.